



KUVENDI I  
KOSOVËS  
Shtator, 2007

## KOMISIONI PËR SHËRBIME PUBLIKE, ADMINISTRATË LOKALE DHE MEDIA

### FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT

Komisioni Parlamentar për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media është njëri nga 11 komisionet funksionale të Kuvendit të Kosovës që përbëhet nga 14 anëtarë që përfaqësojnë partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Fushëveprimtaria e tij shtrihet në tri fusha mjaft të gjëra si: shërbimet publike, administrata lokale dhe mediat. Në bazë të përshkrimit të detyrave, puna e këtij Komisioni konsiston në:

Shqyrtimin e përcaktimit dhe koordinimit të politikës së punës për një shërbim objektiv civil për të gjithë qytetarët pa dallime etnike, mbi bazën e objektivitetit, të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë; projekteve të aftësimit kadrovik dhe profesional të kuadrove për shërbimin civil; Propozimin e



masave për ofrimin e shërbimeve të inxhinierisë dhe të menaxhimit të ndërtesave për IPVO; propozimin e masave për administrimin e sistemit të pagesave dhe listën e pagave të Shërbimit Civil; shqyrtimin e standardeve dhe shërbimeve të teknologjisë informative që duhet përdorur në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes etj. Gjithashtu Komisioni për Shërbime

Publike, Administratë Lokale dhe Media, është përgjegjës për shqyrtimin dhe amendamentimin e ligjeve si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve nga organet ekzekutive. Kompetencat ekzekutive nga këto fusha i mbulojnë: Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Administrimit të pushtetit Lokal, të cilat janë edhe sponsoruesit kryesorë të projektligjeve për të cilat ky komision është funksional.

### PLANI I PUNËS 2007

Më 25 Janar, Komisioni ka miratuar Planin vjetor të punës, me të cilën ka paraparë dinamikën e punëve për vitin 2007. Hartimi i planit të punës në masë të madhe është bazuar në strategjinë legjislative të Qeverisë dhe ka paraparë: shqyrtimin e projektligjeve nga fushat që i mbulon, organizimin e dëgjimeve publike, vizitave në teren, monitorimin e zbatimit të ligjeve etj.

Gjithashtu me këtë plan është marrë parasysh nevoja e thellimit të komunikimit ndërmjet stafit mbështes të Komisionit me zyrat ligjore të Qeverisë, Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Komisioni ka mbetur pas në zbatimin e planit të punës për shkak se ministrinë përkatëse nuk i'u kanë përmbytur afatet për procedimin e projektligjeve në Kuvend ashtu siç është paraparë me strategjinë legjislative të Qeverisë.

### TAKIMET E KOMISIONIT

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni, parashihet të mbajë së paku 2 takime në muaj. Gjatë vitit 2007, ky Komision ka përbushur obligimet e parapara dhe gjatë periudhës Janar-Korrik 2007 ka mbajtur 16 takime. Komisioni gjatë kësaj kohe është mbledhur për qëllime të ndryshme, si: takime me anëtarët e qeverisë të cilët kanë qenë të ftuar për të raportuar para Komisionit shqyrtimin dhe amendamentimin e ligjeve për të cilat Komisioni ka qenë komision funksional si dhe takime me mysafirë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhe kohore komisioni ka zhvilluar dy vizita në terren.

### SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJEVE

Projektligjet të cilat arrijnë në Kuvendin e Kosovës e të cilat janë të fushës së shërbimeve publike, administratës lokale apo mediave, shqyrtohen dhe amendamentohen nga ana e këtij Komisionit. Gjatë vitit 2007, Komisioni ka shqyrtuar tri projektligje, dy prej të cilave janë në shqyrtim e sipër.

Nga muaji janar Komisioni ka shqyrtuar: Projektligjin për shndërrimin e posedueseve të paluajtshmërive private në pronar; Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Librin Amzë 2004/46 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/21 si dhe Projektligjin për Statusin Civil.

Me qëllim të përmirësimit të kualitetit të ligjeve Komisioni ka organizuar disa takime konsultative me zyrtarë të Ministrive përkatëse, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ka angazhuar ekspertë vendor dhe rajonal për të ofruar ekspertizën e tyre në projektligjet të cilat janë në shqyrtim.

### KONTAKT INFORMATAT:

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës. Zyra—E-210

Tel: 038 211 293 dhe 038 211 302

Email: drita.morina@assembly-kosova.org & mirjeta.heta@assembly-kosova.org

**VIZITAT NË TERREN**

Përveç shqyrtimit të projektligjeve Komisioni ushtron edhe funksionin e mbikëqyrjes së punëve të institucioneve ekzekutive dhe adresimin e problemeve me të cilat ato përballen. Komisioni ka ndërmarrë një sërë vizitash në terren për të njohur më mirë me nivelin e zbatimit të ligjeve, mangësitë e ligjeve në zbatim si dhe problemet eventuale me infrastrukturën ligjore në tërësi. Kryesisht këto vizita janë realizuar në qytetet që cilësohen si qendra regjionale. Për zbatimin e Ligjeve nga fusha që mbulon Komisioni kryesisht janë përgjegjëse institucionet e nivelit komunal. Gjatë vitit 2007, Komisioni ka vizituar komunën e Novobërdës dhe pilot komunën e Mamushës. Shqetësimet dhe nevojat e tyre Komisioni i adresoi në institucionet Qendrore relevante.

**AKTIVITETET E  
KOMISIONIT NË TË  
ARDHMEN**

Duke u bazuar në Planin e Punës, Komisioni në të ardhmen do të përqendrohen në shqyrtimin e Projektligjeve që vijnë në fushat që mbulon Komisioni, organizimin e vizitave në terren për të parë nivelin e zbatimit të ligjeve të aprovuar dhe do të vazhdojë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në fuqi.

Në rast të arritjes eventuale të Marrëveshjes për statusin e Kosovës, kujdes të veçantë Komisioni do të kushtoj shqyrtimit të Projektligjeve që janë paraparë me Pakon e Ahtisarit. Gjithashtu nuk do të mungojnë edhe aktivitetet që kanë të bëjnë me monitorimin e implementimit të ligjeve. Komisioni do të bashkëpunoj me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, do të rris vizibilitetin karshi qytetarëve dhe do të vazhdojë punën në mbikëqyrjen e ekzekutivit.

**DËGJIMET PUBLIKE**

Gjatë shqyrtimit të projektligjeve nga ana e komisioneve parlamentare, komisionet kanë të drejtë që të mbajnë dëgjime publike. Dëgjimet publike mbahen në rastet kur anëtarët e Komisionit vlerësojnë se dëgjimi publik do t'u ndihmonte në amenda-men-timin e projektligjit që është në shqyrtim. Qëllimi kryesor i mbajtjes së dëgjimeve publike është shqyrtimi i projektligjeve me efikasitet më të lartë dhe për të përmirësuar kualitetin e ligjeve, Komisionet organizojnë dëgjime publike, përmes të cilave sigurojnë opinionet dhe sugjerimet e ekspertëve të fushave përkatëse, përfaqësuesve të grupeve të interesit, organizatave joqeveritare, shoqatave të ndryshme e sidomos të përfaqësuesve të atyre kategorive të cilat preken më së shumti nga projektligji i cili është në shqyrtim. Kjo i mundëson Komisionit që të ketë një pasqyrë më të qartë për çështjet të cilat i rregullon projektligji dhe i ndihmon në marrjen e vendimeve të duhura. Përveç kësaj komisionet mund të organizojnë edhe dëgjime informative në rastet kur ka vërejtje në zbatimin e ligjeve apo kërkesave për ndryshime eventuale në ligjet në fuqi, me ç'rast ftohen zyrtar të ministrive për të informuar anëtarët e komisionit. Për këtë

qëllim gjatë vitit 2007 Komisioni ka organizuar dy Dëgjime Publike. Njëri kishte të bënte me vërejtjet e Asociacionin e Pavarur të Mediave Elektronike të Kosovës për zbatimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe tjetri me kërkesën e Shoqatës së të Verbërve dhe me njerëzve me të pamë të dobësuar për ndryshimin e Ligjit për RTK-në. Në këto Dëgjime janë ftuar organizata dhe ekspertë të cilat janë ndikuar drejtpërdrejt nga ligjet si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre ligjeve. Dëgjimet Publike, e ndihmojnë Komisionin që të marrë vendime më të drejta dhe në përputhje me interesin e grupeve dhe qytetarëve që preken më së shumti nga zbatimi i atyre ligjeve. Në përpjekje për të lehtësuar organizimin e dëgjimeve publike, së fundi personeli i Komisionit ka përgatitur një bazë të të dhënave me kontakt informatat e organizatave dhe ekspertëve relevantë të cilët mund të ftohen të japin kontributin e tyre gjatë dëgjimeve publike.

**MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË LIGJEVE**

Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës i jep Komisioneve kompetenca për të monitoruar zbatimin e ligjeve për të cilat gjatë shqyrtimit në Kuvend ka qenë Komision funksional. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media ka zhvilluar disa takime me zyrtarët qeveritarë dhe ka ndërmarrë një sërë vizitash në terren për tu njohur me nivelin e zbatimit të ligjeve të aprovuara dhe me problemet dhe nevojat e institucioneve që kanë të bëjnë

direkt me zbatimin e ligjeve. Gjatë këtij viti (2007), Komisioni ka qenë mjaft aktiv në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Në këtë kuadër janë shqyrtuar dhe në vazhdimësi përcillet implementimi i ligjeve për të cilat gjatë miratimit ka qenë Komision funksional. Rëndësi të veçantë i ka kushtuar përputhjes së legjislacionit sekondar me ligjet bazike. Gjatë këtij viti kujdes të veçantë i ka kushtuar: Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare,

Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligjit për përdorimin e Gjuhëve dhe Ligjit për RTK-në. Nga takimet dhe vizitat në terren janë grumbulluar informata të rëndësishme për nivelin dhe problemet në zbatimin e ligjeve. Si problem i veçantë që në zbatimin e ligjeve është identifikuar mungesa e akteve nënligjore që parashohin ligjet, andaj Komisioni së shpejti do të dal me një raport me rekomandime konkrete për ministrinë përkatëse.